



24-08-2021

Prishtinë / Priština

Nr./Br. 2004-2021

Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 64 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 23.08.2021, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për Miratimin e Propozimit të Sekretariatit të KQZ-së për Zbatimin e Rekomandimit Numër 4 të Raportit Përfundimtar të Misionit të Ekspertëve të Zgjedhjeve të Bashkimit Evropian për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 14.02.2021.

- I. Miratohet propozimi i Sekretariatit të KQZ-së, për zbatimin e rekomandimit numër 4 të Raportit përfundimtar të Misionit të Ekspertëve të Zgjedhjeve të Bashkimit Evropian për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 14.02.2021.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së për zbatimin e këtij vendimi.
- III. Propozimi si në pikën I të këtij vendimi është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 23.08.2021

Kryesuesi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve





Data	20.08.2021	Ref. Nr.
Për	Komisionin Qendror të Zgjedhjeve	
Nga	Këshillin e Operacioneve Zgjedhore	
Përmes		
Lënda	Propozimi për zbatimin e rekomandimit numër 4 të Raportit përfundimtar të Misionit të Ekspertëve të Zgjedhjeve të Bashkimit Evropian për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 14.02.2021.	

Të nderuar,

Raporti Përfundimtar i Misionit të Ekspertëve të Zgjedhjeve të Bashkimit Evropian për Zgjedhjet e parakohshme të Republikës së Kosovës të datës 14 shkurt 2021, përmban gjithsejtë pesë (5) rekomandime (faqet e raportit: 44 – 48) që është i ndarë në katër (4) pjesë: Korniza Ligjore, Administrimi i Zgjedhjeve, Kontestet Zgjedhore dhe Mediat (Mediat Sociale dhe të Drejtat Digjitale).

Në faqe numër 47 të Raportit përfundimtar dhe sipas rekomandimit numër 4, ku shkruan si në vijim:

“Në disa faza të procesit, të dhënat personale dhe privatësia e qytetarëve nuk ishin të mbrojtura sa duhet. Rastet e përmendura nga misioni përfshinin publikimin e listave e votuesve (përfshirë votuesit jashtë Kosovës) nga KQZ-ja me detajet personale (emri, mbiemri, data e lindjes), dhe raste të SMS-ve të padëshiruar që nxisnin qytetarët të votojnë për një parti politike dhe këta SMS iu dërguan votuesve në ditën e zgjedhjeve pa pëlqim paraprak dhe në shkelje të heshtjes zgjedhore. LQP dhe rregullorja e KZQ-së nuk janë në përputhje me LMDhP”.

Në proceset e kaluara zgjedhore (parlamentare dhe lokale) lista preliminare e votuesve jashtë Kosovës, ka përmbajtur informatat si në vijim:

- Numri i regjistrimit të votuesit jashtë Kosovës (ky numër i vendoset nga shërbimi i votuesve për nevoja të identifikimit dhe nuk paraqet kurrfarë të dhëne personale),
- Mbiemrin,
- Emrin,
- Datën e Lindjes, dhe
- Komunën.

Me qëllim të zbatimit të rekomandimit numër 4, të këtij raporti, propozojmë që lista e votuesve jashtë Kosovës që publikohet në ueb faqen e KQZ-së, të përmbajë këto të dhëna, si në vijim:

- a) Numrin e regjistrimit të votuesve (të jepen shpjegime më të hollësishme që ky numër nuk përbën të dhënë personale),
- b) Mbiemrin,
- c) Emrin,
- d) Vitin e lindjes,
- e) Komunën, dhe
- f) Shtetin nga ku aplikuesi i regjistruar suksesshëm ka aplikuar për regjistrim për votim jashtë Kosovës.